

Komuna e Klllokotit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Klllokotit hyn në mesin e komunave të themeluara sipas Planit të Ahtisaarit. Kjo komunë ka filluar së funksionari nga janari 2010, pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Ndonëse me Pakon e Ahtisarit si dhe me Ligjin e për Ndarjen e Kufijve Administrativ të Komunave, kjo komunë njihet me emrin Komuna e Klllokotit, në statutin e hartuar dhe miratuar nga organet e kësaj komune figuron se emri i saj zyrtar është Komuna e Klllokotit dhe Verbovcit.¹
2. Komuna e Klllokotit, me popullsi me shumicë serbe, shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës. Përbëhet nga katër zona kadastrale me një sipërfaqe prej 23,4 km² dhe me popullsi prej afërsisht 2.556 banorësh, prej të cilëve 72% janë serbë dhe 28% shqiptarë. Formimi i Komunës së Klllokotit është bërë në territorin e Komunës së Vitisë.
3. Partia Liberale Serbe (SLS) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) bashkë-qeverisin në Klllokot. Kryetar i Komunës së Klllokotit është Sasha Mirković nga SLS, parti e cila ka 10 ulëse në Kuvendin Komunal. SLS pasohet nga LDK e cila ka 5 ulëse. Përfaqësuesi i LDK-së, Refik Halili, mban pozitën e nënkryetarit të komunës. Në Kuvendin Komunal të Klllokotit nuk ekziston asnjë parti opozitare.
4. Në bazë të një hulumtimi të DEMI/USAID, 68% e qytetarëve të kësaj komune janë shprehur të kënaqur me Kryetarin e Komunës, përderisa vetëm 36% e tyre janë shprehur të kënaqur me punën e organeve komunale.²

¹ Komuna e Klllokot-Verbovc. Statuti i Komunës. Nëntor 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/getattachment/Municipality/Statut/STATUTI-KUMUNES-30-11-2012.pdf.aspx>

² Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 14. Shkurt, 2013. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Kllokotit

- 1. Objektet shkollore pa kanalizim dhe ujë të pijes.** Shkollat e Komunës së Kllokotit ballafaqohen me mungesë të lidhjes së tyre me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, mungesa këto që i bëjnë objektet shkollore të mos kenë nivelin e duhur të mirëmbajtjes dhe higjienës. Kësisoj, shkolla fillore “Ratko Markoviq” në fshatin Verbovc nuk ka kanalizim. Ndërsa shkolla “Xhon Sereqi” në fshatin Mogillë nuk ka ujësjellës dhe ngjashëm qëndron edhe shkolla “Sveti Sava” në Kllokot. Por, përveç shkollave, probleme me ujë dhe kanalizim kanë edhe disa fshatra. Kësisoj, fshati Verbovc nuk ka sistem të rregulluar të kanalizimeve, ndërsa pjesa më e madhe e fshatit Mogillë nuk ka sistem të ujësjellësit. Në bazë të disa hulumtimeve, 51% e qytetarëve të Kllokotit janë të pakënaqur me qasjen e objekteve të tyre në rrjetin e kanalizimit.³
- 2. Vërshimet nga lumi “Morava e Binçes”.** Dëmet që u shkaktohen banorëve të Komunës së Kllokotit si pasojë e vërshimeve nga lumi “Morava e Binçes” konsiderohen të mëdha, sidomos në fshatin Mogillë dhe në vetë qytezën e Kllokotit. Dëme u shkaktohen edhe nëpër shtëpi të banimit, por veçmas në tokat bujqësore të fshatit Mogillë.⁴
- 3. Mos funksionimi i ndriçimit publik.** Komuna e Kllokotit, duke përfshirë edhe fshatrat e kësaj ane kanë të instaluar ndriçimin publik. KEK-u, deri tani, e ka ndërprerë ndriçimin publik disa herë, shkak i mos pagesës së energjisë së shpenzuar nga ana e komunës. Në fund të vitit 2012, kjo komunë i ka borxh ndërmarrjeve publike afro 50.000 euro, ku mbi 60% e këtij borxhi është ndaj KEK-ut.⁵
- 4. Shkalla e vogël e të hyrave komunale.** Autoritetet lokale në Kllokot e kanë të pamundur të bëjnë investime të mëdha në lokalitetet e kësaj ane, për shkak të të hyrave të ulëta vetanake. Gjatë 2012, kjo komunë ka realizuar të hyra në vlerë prej 74.000 euro.⁶ Nga ana tjetër, komuna akoma nuk ka nisur me procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit të objekteve private si dhe nuk janë

³ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁴ Shoqata Kulturore “Zëri ynë”. Përmytje ne shume komuna të Kosovës. Burimi: <http://www.zeri-yne.org/zeryne/lajme/43-tjera/358-permytje-ne-shume-komuna-te-kosoves.html>

⁵ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2012. Fq 21. Burimi: http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKL_2012_Shqip_631782.pdf

⁶ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti Financiar janar – dhjetor 2012. Fq 13.

regjistruar të hyra nga përkthimi apo regjistrimi i pronave bujqësore. Përveç kësaj, komuna nuk ka nisur akoma të marr tatime nga bizneset private që funksionojnë në këtë komunë. Mungesa e këtij konsolidimi të brendshëm duhet evitohet me qëllim të rritjes së të hyrave dhe zgjerimin e mundësisë për investime.⁷

- 5. Prezenca e strukturave paralele.** Komuna nuk ka arritur t'i largojë strukturat paralele të Serbisë që ofrojnë shërbime administrative dhe teknike qytetarëve në këtë lokalitet. I tërë sistemi shëndetësor dhe ai arsimor në këtë komunë kontrollohet nga ana e strukturave paralele. Këto institucione paralele nuk njohin dokumentet e lëshuara për qytetarë nga ana e institucioneve të Kosovës. Kjo gjë ua pamundëson qytetarëve marrjen e shërbimeve, veçmas në objektet shëndetësore. Ky dualizëm në qeverisje vazhdon të shkaktojë huti tek qytetarët dhe shpesh herë mosmarrëveshje mes tyre.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Burimet e ujit mineral:** Komuna e Kllkotit është vendbanimi më tipik në Kosovë për gjetjet e burimit të ujit mineral. Mungesa e kanalizimeve dhe hapja e gropave septike i kanë dëmtuar këto burime në disa raste. Autoritetet komunale do të duhej të ndërmerrnin masa në ruajtjen e këtyre burimeve si dhe në gjetjen e mënyrave për përdorimin dhe eksplotimin e tyre. Kjo komunë është e njohur për “Banjën e Kllkotit” si një qendër rehabilituese dhe shëruese e cila bazohet përgjithësisht në ujin mineral të kësaj ane.
- 2. Ndriçimi publik:** Komuna e Kllkotit ka arritur menjëherë pas themelimit të zgjerojë pothuajse në të gjitha vendbanimet sistemin e ndriçimit publik. Por, pas shtirjes së rrjetit, komuna ka dështuar të mirëmbaj ndriçimin publik. Në shumë vende, poqët e ndriçimit shihen të thyera dhe nuk janë ndërruar apo zëvendësuar asnjëherë. Banorët e kësaj komune kërkojnë nga Komuna që të mirëmbaj ndriçimin publik.

⁷ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2012. Fq 13-14. Burimi: http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKL_2012_Shqip_631782.pdf

Trendet Buxhetore në Komunën e Kllokotit

Kllokoti është njëra ndër komunat me buxhetin më të vogël në vitin 2013 me gjithsej 990 mijë euro. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune ka shënuar një ngritje prej 425 mijë euro apo 75%. Kjo ngritje ka ardhur pjesërisht edhe si pasojë e rritjes së të hyrave vetanake pasi që nga viti 2010 kjo komunë ka pasur një rritje graduale të të hyrave. Në vitin 2012, kjo komunë ka pasur 74 mijë euro të hyra vetanake. Disa prej pengesave që kjo komunë ka hasur në realizimin e të hyrave në vitin 2012 janë⁸:


- a) mos bartja e dosjeve të tatimpaguesve nga Komuna e Vitisë;
- b) mos ngarkimi me taksa të bizneseve për shkak të mungesës së stafit.

Në vazhdim, në këtë komunë janë të regjistruara 1122 prona ndërsa vetëm 235 prej tyre kanë kryera pagesat në mënyrë të rregullt deri më tani. Numri i pronave të paregjistruara është 50.⁹

⁸ ZAP. Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Gjilanit Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKL_2012_Shqip_631782.pdf

⁹ Komuna e Kllokotit, Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP. 16 Gusht 2013

Figura 1. Buxheti i Komunës së Kllokotit 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?kllokot/2013#/~/~kllokot>

Grafikoni i trendeve të ndarjeve buxhetore (fig.2) tregon për një ngritje të theksueshme të investimeve kapitale gjatë katër viteve të kaluara, ku rritja më e madhe është shënuar në vitin 2011 në shumën prej afro 1 milionë euro.

Sa i përket kontrollit të shpenzimeve në vitin 2010, auditori ka gjetur këto parregullsi:

- mos nënshkrim të raportit të vlerësimit;
- lidhje e marrëveshjeve mes kryetarit dhe punë kryerësve pa procedurë të tenderimit;
- mungesë e rregulloreve për ndarje të subvencioneve etj.

Figura 2. Ndarjet Buxhetore 2010- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Buxhetit, komuna e Kllokotit do të ketë një ulje graduale të të hyrave për shkak të uljes së grantit qeveritar, ndërsa të hyrat vetanake planifikohet që të rriten në të ardhmen. Komuna synon që buxhetin të orientojë në këto objektiva: a) mbrojtja dhe përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës; b) kthimi i të zhvendosurve; c) zhvillimi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale etj.

Tabela 1. Buxheti 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	872.195	741.083	757.604
Të hyrat vetanake	80.000	85.000	90.000
Grantet	792.195	656.083	667.604

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të shumta për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Kllokotit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.